Së dyti, lidhur me normativat dhe direktivat e sipërcituara, në mënyrë që të mos krijohet konfuzion si për OE-të në ofertim por edhe për KVO-në në vlerësimin e ofertave, Autoriteti Kontraktor mjaftohet së kërkuari që materialet në fjalë të jenë të certifikuara/markuara **CE ose FDA**, duke evituar përcaktime të mëtejshme. Kjo në mbështetje edhe të përcaktimeve të Nenit 17 të Ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjekësore” si dhe të nenit 7 të ligjit 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014”.

1. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara.
2. Operatori Ekonomik duhet të planifikojë kryerjen e këtyre testeve në bashkëpunim me stafin tonë bazuar në specifikimet e prodhuesit.
3. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët tanë/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
4. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
5. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

-
6. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Detyrat:

Mirëmbajtja e plotë e pajisjeve do të thotë se duhet të kryejë mirëmbajtjen parandaluese/preventive sikurse e cilëson prodhuesi, mirëmbajtjen korrigjuese të secilës pajisje dhe pjesëve përbërëse për çdo defekt të mundshëm pa përjashtuar pjesë specifike, inspektimin e sigurisë elektrike të pajisjeve mjekësore, furnizim dhe ndërrimin e pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve si dhe transferimin dhe instalimin me kërkesë nga Autoriteti Kontraktues.

Kërkesa të tjera :

Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, (plan, i cili duhet të jetë 2 (dy) vjeçar në përputhje me afatin e marrëveshjes kuadër), për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollet që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane.

Shënim:

Autoritet Kontraktor gëzon të drejtën të përjashtojë nga mirëmbajtja, çdo pajisje objekt shërbimi në këtë procedure prokurimi, në rast se pajisja del end-of-support, dhe OE do ta pranojë pa pasoja për AK.

Minikontratat do të lidhen sipas loteve, me zëra të veçantë, bazuar në periudhën e garancisë dhe periudhën e mbulimit "Full Risk" nga prodhuesi.

Kontratat do të lidhen, me kërkesën e Sektorit të IT (Inxhinieria Biomjekësore), bazuar në periudhën e mbulimit të shërbimit, për çdo ditë kalendarike, brenda periudhës së Marrëveshjes Kuadër.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: "Spitali Rajonal Korçë".

Afati i kryerjes së shërbimeve: 24 (njëzet e katër) muaj ose 730 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 3: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” E PAJISJES MJEKËSORE CT SCANNER - PRODHUES PHILIPS/ OSE EKVIVALENT” PËR SPITALIN RAJONAL KORÇË”.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent". Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Aksesorët	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Sasia	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	“Mirëmbajtje “Full Risk” e pajisjes mjekësore CT Scanner- prodhues Philips/ ose ekuivalent”	1.Sistemi CT Scanner 64 prerje 2.ISP IX / LX workstation 3.CT Console 4.UPS 5. Kabineti Baterive 6. Injктору i Kontrastit	CT Scanner	Philips Healthcare / ekuivalent	Incisive CT Essentials / ekuivalent	1	Spitali Rajonal Korçë	24 muaj/ 730 ditë

Shënim: Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.

Shënim: Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.

Nevojat për organizimin funksional/strukturor të operatorit kontraktues dhe të ofrimit të shërbimit për mirëmbajtjen e plotë “full risk” të pajisjeve janë të grupuara në disa kategori.

❖ Specifikimet Teknike të Përgjithshme

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga prodhuesi (MAF) / ose Autorizim nga Distributori i Autorizuar (DAF) (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjes mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi të jetë i vlefshëm. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.
2. Operatori Ekonomik duhet të ketë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email).
3. Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve.
4. Stafii (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambjentet e Kontraktuesit dhe të shoqerohet nga stafi i ynë.
5. Ofertuesi (OE) duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambjentet e Spitalit Rajonal Korçë, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura të punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e tij.

❖ Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjes mjekësore

1. Mirëmbajtja parandaluese apo preventive të pajisjes mjekësore duhet të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërimi apo përkeqësimi i performancës.
2. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 1 (një) Inxhinier/Specialist në stafin e vet të trajnuar për pajisjen mjekësore objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.
3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet.
4. Me lidhjen e kontratës duhet kryer për pajisjen mirëmbajtja preventive, sipas planit të paraqitur. Operatori Ekonomik (OE) duhet të planifikojë dhe koordinojë mirëmbajtjen preventive në bashkëpunim me stafin tonë dhe përdoruesin (stafin mjekësor), dhe ta kryejë jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i kontratës.
5. Pavarësisht planit të parashikuar të mirëmbajtjes preventive, OE duhet të kryejë kontroll periodik mujor të funksionimit të pajisjes.
6. Në përfundim të çdo kontrolli apo mirëmbajtjeje preventive të kryer, duhet të mbahet një raport për faktin. Raporti duhet të jetë i firmosur nga përfaqësuesi i Shërbimit ku ndodhet pajisja, përfaqësuesi ynë dhe Inxhinieri/Tekniku i OE i cili do të kryejë kontrollin/mirëmbajtjen. Modeli i këtij raporti është i standartizuar nga AK.
7. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë kontrolle apo verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

❖ **Mirëmbajtja korrigjuese e Pajisjeve mjekësore**

1. Ndërhyrjet e mirëmbajtjes korrigjuese konsistojnë në përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionimi, në identifikimin e shkaqeve, eliminimin e tyre dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, për garantimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe sigurisë së saj.
2. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshëm gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me të, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit mjekësor sic mund të jenë: Dedektorë, Kompjuterat, Hard Drive, DVD-CD, Keyboard, Monitor, RAM, Ups, Bllok ushqimi, printer, infrastrukture rrjeti, fisha, sonda, mansheta, sensorë, elektroda, ingranazhe, pjesë elektronike, elektrike, mekanike, hidraulike, valvula, pjesë mekanike, rrota, pistonat, motorrë etj, dhe ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi.
3. Pjesët e demtuara të këmimit, pas zëvendësimit me të reja, do të merren nga subjekti kontraktues.
4. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të paraqitet për të kontrolluar e verifikuar defektin brenda 24 orëve nga marrja e njoftimeve (me e-mail dhe/ose telefon të dhënat e kontaktit të paraqitur) nga Sektori i Inxhinierisë Klinike për mosfunksionimin normal, probleme të ndryshme apo defekte të pajisjes.
5. Në rastin kur nuk nevojiten pjesë këmbimi, korrigjimi i defektit duhet të realizohet jo më vonë se 48 orë pas marrjes së njoftimit.
6. Në rast se konstatohet se për korrigjimin e një defekti nevojiten pjesë këmbimi, OE duhet të furnizojë dhe të vendosë pjesët e këmbimit, të riparojë defektin dhe të vendosë pajisjen në gjendje normale pune brenda 7 ditëve kalendarike nga data e hartimit të procesverbalit, të standartizuar nga AK, për nevojën e pjesëve të këmbimit të firmosur nga specialisti ynë, Stafit mjekësor përdorues i pajisjes dhe inxhinieri i Shoqërisë së kontraktuar (OE).
7. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të garantojë që nuk do të kalojë afatin prej 10 ditësh për rivendosjen në funksion të pajisjes.
8. Pas riparimeve apo ndërhyrjeve të kryera, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sikurse e rekomandon prodhuesi, për garantimin e funksionimit normal të pajisjes.
9. Pas çdo riparimi, zëvendësimi pjesësh këmbimi apo aksesorësh, pajisja duhet të rivendoset në gjendje të plotë pune.
10. Lëvizja, spostimi, çmontimi dhe rimontimi i pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes korrigjuese është në ngarkim dhe përgjegjësi të kontraktuarit.
11. Pas çdo riparimi apo zëvendësimi të pjesëve duhet të mbahet një procesverbal (i standartizuar nga AK) apo Raport Servisi, formati i të cilit miratohet dhe unifikohet nga AK, që përshkruan në mënyrë të detajuar dhe të qartë defektin/problemin, pjesët e zëvendësuara në qoftë se ka, kalibrimet dhe provën e funksionit. Raporti i Servisit duhet të firmoset nga Shefi i Shërbimit ku ndodhet pajisja ose persona të autorizuar prej tij (staf mjekësor përdorues i pajisjes), specialisti i ynë dhe tekniku apo inxhinieri i shoqërisë së kontraktuar për mirëmbajtjen.
12. Për pajisjen CT Scanner, shoqëria e kontraktuar do mundësojë vetëm një herë lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

❖ **Furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesorë**

1. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhuesi tjetër të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitetin me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
2. Të jenë të certifikuar me CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara në tregun Europian.

3. Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesorët duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
4. Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kësaj kontrate. i kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit/ ose arrijen e maksimumit të konsumit të vërtetuar nga prodhuesi.)

❖ Inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore

“Inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore: Operatori Ekonomik duhet të kryejë të paktën 1(një) inspektim sigurie sipas standartit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, për pajisjen mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, kur kjo është e zbatueshme. AK të pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.”

Së pari, në lidhje me kërkesën që OE të paktën 1 (një) një inspektim sigurie sipas standartit ndërkombëtar elektrik IEC 62353, sqarojme; IEC 62353 Pajisjet elektrike mjekësore - Testimi i përsëritur dhe testimi pas riparimit të pajisjeve elektrike mjekësore. IEC 62353 zbatohet për testimin e pajisjeve elektrike mjekësore dhe sistemeve elektrike mjekësore, ose pjesë të pajisjeve ose sistemeve të tilla, të cilat përpunohen me IEC 60601-1:1988 dhe ndryshimet e tij dhe IEC 60601-1:2005 dhe ndryshimet e tij, para se të vihen në përdorim.

Së dyti, lidhur me normativat dhe direktivat e sipërcituara, në mënyrë që të mos krijohet konfuzion si për OE-të në ofertim por edhe për KVO-në në vlerësimin e ofertave, Autoriteti Kontraktor mjaftohet së kërkuari që materialet në fjalë të jenë të certifikuara/markuara **CE** ose **FDA**, duke evituar përcaktime të mëtejshme. Kjo në mbështetje edhe të përcaktimeve të Nenit 17 të Ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjekësore” si dhe të nenit 7 të ligjit 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014”.

1. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara.
2. Operatori Ekonomik duhet të planifikojë kryerjen e këtyre testimeve në bashkëpunim me stafin tonë bazuar në specifikimet e prodhuesit.
3. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët tanë/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
4. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
5. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.
6. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Detyrat:

Mirëmbajtja e plotë e pajisjeve do të thotë se duhet të kryejë mirëmbajtjen parandaluese/preventive sikurse e cilëson prodhuesi, mirëmbajtjen korrigjuese të secilës pajisje dhe pjesëve përbërëse për çdo defekt të mundshëm

pa përjashtuar pjesë specifike, inspektimin e sigurisë elektrike të pajisjeve mjekësore, furnizim dhe ndërrimin e pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve si dhe transferimin dhe instalimin me kërkesë nga Autoriteti Kontraktues.

Kërkesa të tjera :

Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, (plan, i cili duhet të jetë 2 (dy) vjeçar në përputhje me afatin e marrëveshjes kuadër), për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollet që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane.

Shënim:

Autoritet Kontraktor gëzon të drejtën të përjashtojë nga mirëmbajtja, çdo pajisje objekt shërbimi në këtë procedure prokurimi, në rast se pajisja del end-of-support, dhe OE do ta pranojë pa pasoja për AK.

Minikontratat do të lidhen sipas loteve, me zëra të veçantë, bazuar në periudhën e garancisë dhe periudhën e mbulimit “Full Risk” nga prodhuesi.

Kontratat do të lidhen, me kërkesën e Sektorit të IT (Inxhinieria Biomjekësore), bazuar në periudhën e mbulimit të shërbimit, për çdo ditë kalendarike, brenda periudhës së Marrëveshjes Kuadër.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: ”Spitali Rajonal Korçë”.

Afati i kryerjes së shërbimeve: 24 (njëzet e katër) muaj ose 730 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 4: “MIRËMBAJTJA “FULL RISK” PAJISJES MJEKËSORE GRAFI DIGJITALE TË PRODHUSIT SHIMADZU/ OSE EKVIVALENT” PËR DREJTORINË E SHËRBIMIT SPITALOR SARANDË.

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent". Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësi dhe energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Sasia	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	“Mirëmbajtja “Full Risk” pajisjes mjekësore Grafi Digjitale të prodhuesit Shimadzu / ose ekuivalent”	Grafi digjitale	Shimadzu / ekuivalent	RADSPEED FIT / ekuivalent	1	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë	24 muaj/ 730 ditë

Shënim: Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjet do të jetë Full risk ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korigjuese për të gjithë difektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajtja full risk duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjeve, vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure, janë pajisje shumë komplekse. Përdorimi i këtyre pajisjeve kërkon staf të kualifikuar e çertifikuar nga prodhuesi. Riparimi i këtyre pajisjeve duhet të kryhet vetëm nga specialistë të kualifikuar dhe të trajnuar posaçërisht për secilën nga pajisjet, pranë prodhuesve respektive si dhe të autorizuar prej tyre, për shkak jo vetëm të kompleksitetit por edhe të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin për shëndetin e njerëzve.

Duhet marrë gjithmonë masat për zëvendësimin në kohë të saj si dhe pjesëve të këmbimit me qëllim mosndërprerjen e funksionimit të shërbimit.

❖ **SPECIFIKIMET TEKNIKE** për Mirëmbajtjen “Full Risk” e pajisjes mjekësore grafi dixhitale të prodhuesit Shimadzu .

Shërbimet që duhet të ofrohen: ***Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesve përkatës të pajisjeve mjekësore që janë në përdorim në disa spitale të vendit sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit.***

Shërbimet që duhet të ofrohen:

❖ **Mirëmbajtja parandaluese:**

Ky shërbim duhet të kryhet sipas rekomandimeve të prodhuesit, për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.

❖ **Mirëmbajtja korigjuese:**

Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, në identifikimin e shkaqeve, në eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, në verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjet përkatëse.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontroleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.

Te gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rrezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjet përkatës.
- Gjeneratori I rrezeve x
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur difektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.

Shënim* *Ne Full Risk nuk përfshihen dëmtimet fizike (thyerje/goditje/perplasje) të pjesëve përbërëse të këtij sistemi Xrey, PC, Monitor, Dedektor,Router, Printer. Te shkaktuar nga persona te paautorizuar apo nga vet personeli.*

I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjate kryerjes se shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimin.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve:

Personeli teknik i të Kontraktuarit do të garantojë mbulimin e shërbimit për 52 javë në vit, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia dhe shpeshtësia e ndërhyrjeve.

I Kontraktuari duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I Kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda ditës 24 orë për spitalet më larg se 100 km. Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 7(shtatë) ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit. “

Vendi i kryerjes së shërbimeve: “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë”.

Afati i kryerjes së shërbimeve: 24 (njëzet e katër) muaj ose 730 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 1: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” E PAJISJES MJEKËSORE CT SKANER 128 SLICE E PRODHUESIT GE / OSE EKVIVALENT” PËR QSUNT”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Vendi i kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	“Mirëmbajtje full risk e një pajisje CT Skaner 128 Slice e prodhuesit GE / ose ekuivalent”	CT Skaner 128 Slice	GE Healthcare / ekuivalent	Revolution HD 128SL / ekuivalent	QSUNT/ PAI Polivalent	24 muaj/ 730 ditë

Shënim: Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzet e katër) muaj ose 730 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 2: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK”E PAJISJES MJEKËSORE MRI - PRODHUES PHILIPS / OSE EKVIVALENT” PËR SPITALIN RAJONAL KORÇË”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Aksesorët	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Sasia	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	“Mirëmbajtje “Full Risk”e pajisjes mjekësore MRI - prodhues Philips / ose ekuivalent”	1. Sistemi MRI 2. Anestezia Kompatibël MRI 3. Monitor Pacienti MRI Kompatibël 4. Injektor Kontrasti MRI Kompatibël 5. Set Laringoskopë (4 copë) 6. Chiller 7. UPS + Kabinet Baterish 8. Kabina e Faradeit 9. Workstation 10. Bobinat (Coils) (9 copë)	Rezonancë Magnetike MRI	Philips Healthcare / ekuivalent	INGENIA 1.5T / ekuivalent	1	Spitali Rajonal Korçë	24 muaj/ 730 ditë

Shënim: Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzet e katër) muaj ose 730 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 3: “MIRËMBAJTJE “FULL RISK” E PAJISJES MJEKËSORE CT SCANNER - PRODHUES PHILIPS/ OSE EKVIVALENT” PËR SPITALIN RAJONAL KORÇË”.

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Aksesorët	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Sasia	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	“Mirëmbajtje “Full Risk” e pajisjes mjekësore CT Scanner- prodhues Philips / ekuivalent”	1.Sistemi CT Scanner 64 prerje 2.ISP IX / LX workstation 3.CT Console 4.UPS 5. Kabineti Baterive 6. Injektori i Kontrastit	CT Scanner	Philips Healthcare / ekuivalent	Incisive CT Essentials / ekuivalent	1	Spitali Rajonal Korçë	24 muaj/ 730 ditë

Shënim: Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzet e katër) muaj ose 730 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 4: “MIRËMBAJTJA “FULL RISK” PAJISJES MJEKËSORE GRAFI DIGJITALE TË PRODHUSIT SHIMADZU/ OSE EKVIVALENT” PËR DREJTORINË E SHËRBIMIT SPITALOR SARANDË”

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Lloji i Pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Sasia	Vendi i Kryerjes së Shërbimit	Afati i ekzekutimit të Shërbimit
1.	“Mirëmbajtja “Full Risk” pajisjes mjekësore Grafi Digjitale të prodhimit Shimadzu / ose ekuivalent”	Grafi Digjitale	Shimadzu / ekuivalent	RADSPEED FIT / ekuivalent	1	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë	24 muaj/ 730 ditë

Shënim: Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqitet cmimi/vlera për ditë shërbimi.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzet e katër) muaj ose 730 ditë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 1: “Mirëmbajtje “Full Risk” e pajisjes mjekësore CT Skaner 128 slice e prodhuesit GE / ose ekuivalent” për QSUNT”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Qendra Spitalore Universitare Tiranë”.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 2: “Mirëmbajtje “Full Risk”e pajisjes mjekësore MRI - prodhues Philips / ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Korçë”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Spitali Rajonal Korçë”

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 3: “Mirëmbajtje “Full Risk” e pajisjes mjekësore CT Scanner - prodhues Philips / ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Korçë”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Spitali Rajonal Korçë”

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Loti 4: “Mirëmbajtja “Full Risk” pajisjes mjekësore Grafi Digjitale të prodhimit Shimadzu / **ose ekuivalent**” për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike.

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë”.

(E NJËJTË PËR TË GJITHA LOTET)

Shtojca 9.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit.

Shënim: Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent** në përputhje e objektin e prokurimit e cila të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën **ISO 13485 për “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalente** ne perputhje me objektin e prokurimit. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) Inxhinierë Biomedikal/ Elektronik/ Mekatronik/ Informatik ose çdo arsim tjetër i ngjashëm/ Specialist në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet:

- *Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit;*
- *Certifikatat / dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,*
- *Kontrata e punes e vlefshme ose Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore te muajit te fundit.*
- *CV.*

Shënim: *Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë **Autorizim nga prodhuesi / MAH /** ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet te jete original ose kopje e perkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshem ne momentin e hapjes se ofertave.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër kryerjen e shërbimit ‘full risk’, mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjesë të mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat jnë të lidhura me pajisjen, sipas specifikimeve teknike.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambientet e AK-ve përfituese.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëje me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafi (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqerohet nga stafi teknik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(E NJËJTË PËR LOTET 3 & 4)

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit te lotit.

Shënim: Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së fondit limit te lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
